

Mandati ynë

Swisscontact është duke zbatuar Programin Zviceran për Nxitjen e Importeve (SIPPO), në emër të Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO). Ne jemi një partner kompetent dhe i fuqishëm për SECO-n, të aftë për të zbatuar programin në mënyrë profesionale, të orientuar nga biznesi dhe tregu. Ne e zgjerojmë kompetencën tonë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me partnerët nënkontraktues, HELVETAS Swiss Intercooperation dhe BHP Brugger & Partners Ltd.

Vlerat Tona Themelore

Vlerat themelore në vijim krijojnë bazën për sjelljen tonë ndaj punonjësve tanë dhe partnerëve tanë kontraktues, gjatë ofrimit të shërbimeve tona për palët e interesuara.

Respekti

Ne i respektojmë të gjithë njerëzit dhe promovojmë të drejtat e barabarta. Ne nuk bëjmë diferencim përsa i përket gjinisë, origjinës etnike, fesë, kulturës, arsimit, statusit shoqëror, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual, statusit familjar, vlerave politike apo kombësisë. Të gjitha veprimet ose deklaratat që i vënë individët në disavantazh, i poshtërojnë ose i vënë ata në lojë, konsiderohen si akte diskriminimi dhe si të tilla konsiderohen të patolerueshme.

Bashkëpunimi me bazë Partneritetin

Bashkëpunimi ynë me partnerët dhe grupet e synuara është i drejtë, i besueshëm dhe i bazuar në transparencë, besim, ndershmëri dhe respekt të ndërsjelltë. Ne nxitim qasjet konstruktive për menaxhimin e konfliktit.

Integriteti

Ne mbrojmë privatësinë, pronësinë intelektuale dhe të dhënat e ndjeshme për biznesin.

Partnerët tanë ndajnë me ne informacion konfidencial në lidhje me biznesin. Ne kemi si detyrim respektimin dhe ruajtjen e këtij informacioni që na është besuar, përveç rasteve kur dhënia e këtij informacioni është shprehimisht e autorizuar apo ligjërisht e kërkuar.

Ne shmangim konfliktet e interesit.

Ne kujdesemi në mënyrë të mjaftueshme për të ndarë biznesin nga sferat private. Ne i zbulojmë konfliktet e interesave menjëherë dhe i zgjidhim ato në një mënyrë që është objektivisht e verifikueshme dhe e kuptueshme për të gjitha palët e përfshira.

Ne nuk tolerojmë asnjë formë korrupsioni, ryshfeti apo mashtrimi.

Ne nuk pranojmë dhe as nuk bëjmë dhurata apo favore të tjera (pará, hua, shpërblime, çmime të reduktuara apo pagesa, etj.) gjatë marrëdhënies tonë me partnerët, kompanitë, bashkëpunëtorët dhe zyrtarët publikë.

Përgjegjësia jonë

Ne nxisim tregtinë me përgjegjësi shoqërore, miqësore me mjedisin, gjithëpërfshirëse dhe si e tillë tregtinë e qëndrueshme. Me këtë Kod, ne përcaktojmë një sërë vlerash thelbësore, të cilat udhëheqin punën tonë të përditshme dhe sjelljen tonë ndaj punonjësve dhe palëve të interesuara. Këto vlera duhet të zhvillohen më tej me masa specifike, në një proces të vazhdueshëm dhe do të plotësojnë politikën, udhëzimet dhe rregullat tona të ardhshme.

Si lehtësues për shërbimet e tregtisë dhe sa i përket rolit tonë qendror në një rrjet mbarëbotëror të partnerëve dhe palëve të interesuara, ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë për të jetuar, komunikuar dhe për t'i shpërndarë këto vlera themelore në mënyrë aktive. Ne e shohim veten në një pozitë të jashtëzakonshme për të nxitur lidhjen mes tregtarëve të eksportit dhe importit - jo vetëm nëpërmjet tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, por edhe nëpërmjet vlerave të ndërsjellta për respekt dhe qëndrueshmëri. Përmes mënyrës sesi sillemi dhe komunikojmë, ne shërbejmë si model dhe promovojmë vlerat e këtij Kodi të Sjelljes në mënyrë proaktive dhe në mënyrë të rregullt, për të gjithë palët tona të interesuara.

Ne çdo vit raportojmë dhe publikojmë aktivitetet dhe kontributet tona për vlerat e këtij Kodi.

Pajtueshmëria me Ligjin

Ne zbatojmë të gjitha ligjet në fuqi për aktivitetet tona në Zvicër dhe në vendet përkatëse partnere, në emër të SIPPO si dhe kryejmë detyrat tona në mënyrë transparente dhe etike. Nëse një ligj bie ndesh me një politikë të përfshirë në këtë Kod të Sjelljes, ne i përmbahemi ligjit; megjithatë, nëse një zakon apo politikë lokale bie në kundërshtim me këtë Kod të Sjelljes, ne i përmbahemi Kodit.

Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes së Swisscontact

Të gjithë individët që punojnë për SIPPO-n nën emrin dhe statusin ligjor të Swisscontact duhet t'i përmbahen Kodit të Sjelljes së Swisscontact, i cili është një pjesë përbërëse e të gjitha kontratave të punës dhe kushteve të shërbimit të Swisscontact për të gjithë të punësuarit.

Partnerët Kontraktues dhe Palët e Interesuara

Ne i kryejmë detyrat tona në kuadrin e një rrjeti botëror të përbërë nga partnerë kontraktues, si dhe nga palë të interesuara dhe aktorë qeveritarë dhe joqeveritarë në sektorin privat.

Në parim, ne u bëjmë thirrje të gjithë partnerëve tanë kontraktues dhe palëve të interesuara që të ruajnë vlerat themelore të këtij Kodi, pavarësisht nëse ekziston ose jo një marrëveshje me shkrim. Përputhshmëria me Kodin siguron reputacionin tonë, të partnerëve tanë kontraktues dhe të palëve të interesuara. Ne presim që partnerët tanë kontraktues të sigurojnë që nënkontraktorët e tyre dhe palët e interesuara përgjatë zinxhirit të vlerës t'i përmbahen këtij Kodi dhe standardeve shtesë, certifikatave dhe etiketave.

Për partnerët tanë kontraktues, Kodi ose pjesë të tij mund të përfshihen në marrëveshjen tonë të përbashkët me shkrim. Gjithashtu, ne mund të kërkojmë në marrëveshje respektimin e standardeve të cilësisë, të certifikatave dhe etiketave të njohura në shkallë ndërkombëtare në lidhje me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve. Në raste të veçanta, ne mund t'ju ofrojmë ndihmë dhe këshilla partnerëve tanë kontraktues, për t'i mundësuar atyre dhe nënkontraktuesve dhe furnizuesve të tyre që të veprojnë në përputhje me vlerat e këtij Kodi dhe me kërkesat e mëtejshme përsa i përket cilësisë.

Udhëzimet tona për Tregti të Qëndrueshme

Për të adresuar misionin tonë për një tregti të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ne ndjekim Dhjetë Parimet e *Global Compact* të Kombeve të Bashkuara (UNGC). Duke i përfshirë këto parime në strategjitë, politikat dhe procedurat tona dhe duke krijuar një kulturë integriteti, ne jo vetëm që respektojmë përgjegjësitë tona themelore, por krijojmë edhe kushtet për suksesin tonë afatgjatë.

Të drejtat e Njeriut

- Ne mbështesim dhe respektojmë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të shpallura ndërkombëtarisht; dhe
- sigurohemi që ne dhe partnerët tanë të mos jenë bashkëpunëtorë në abuzimet me të drejtat e njeriut.

Puna

- Ne mbështesim lirinë e organizimit në shoqata dhe njohjen efektive të së drejtës për negociata kolektive;
- eliminimin e të gjitha formave të punës së detyruar dhe të detyrueshme;
- zhdukjen efektive të punës së fëmijëve; dhe
- eliminimin e diskriminimit që ka të bëjë me punësimin dhe profesionin.

Mjedisi

- Ne mbështesim qasjet parandaluese ndaj sfidave mjedisore;
- ndërmarrim nisma për të promovuar përgjegjësi më të madhe mjedisore; dhe
- nxisim zhvillimin dhe shpërndarjen e teknologjive miqësore me mjedisin.

Anti-Korrupsioni

- Ne punojmë kundër korrupsionit në të gjitha format e saj, duke përfshirë edhe zvatjen dhe rryshfetin.

Raportimi i Shkeljeve

Partnerët tanë dhe palët e interesuara duhet të raportojnë për çdo shkelje të dyshuar të këtij Kodi, të rregulloreve dhe ligjeve.

Për të mundësuar një vlerësim të shpejtë dhe zbatimin e veprimeve të përshtatshme korrigjuese, informatori mund të mos raportojë në mënyrë anonime. Sidoqoftë, mbrojtja dhe konfidencialiteti garantohen nga pavarësia e personit kontaktues të emëruar dhe të udhëzuar në Handel Schweiz, shoqata për tregtinë zvicerane:

Handel Schweiz, Güterstrasse 78, CH-4053 Basel; +41 61 228 90 30;

www.handel-schweiz.com; info@handel-schweiz.com.